

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Substancë para plazmaferezës? Misteri i vdekjes së këngëtarit grek Giorgos Mazonakis, çfarë dyshojnë hetuesit
ADRESA	https://piranjat.al/showbiz/substance-para-plazmaferезes-misteri-i-s-se-kengetarit-grek-giorgo-i104329
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 20:47:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 20:43:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8b9a5708f10a992cf9f2901b68869431b8e3319cce7ff36231fcecaa5716c18c
TEKSTI	139a8d97bc45891e995eeb6b4adf42bc2b796cf59bf9c2becd84036d1853fdeb
PAMJA	aa32f3e5b9b863c7ca5619f5c7414ca2a8f8bbe30bc988ac3bafa66adbaa379f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	899dbc44b17f19bd0cd999473e9bf32d6af42bda9178995538136a4f4652ac9b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aa0d8cfc8113ea79b7663cf26341788a60de665698217179c4b01fa71930ced4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/899dbc44b17f19bd0cd999473e9bf32d6af42bda9178995538136a4f4652ac9b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **mbi 33 miliardë dollarë** Donald Trump se SHBA-të nuk **kriminell** Balla i cili ishte në... **anulon dërgesat drejt** evropiane, të planifikuara në fuqi **se Zegjine** Çaushit ngre pikëpvetie: A **edhe për** pagat e qivatarëve e ne përberjen e komisioneve e adamanata

[SHOWBIZ](#)

Substancë para plazmaferezës? Misteri i vdekjes së këngëtarit grek Giorgos Mazonakis, çfarë dyshojnë hetuesit

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 22:43



Hetimi për vdekjen e Giorgos Mazonakis po merr një tjetër drejtim, ndërsa autoritetet greke po fokusohen te provat dixhitale të sekuestruara, veçanërisht te një prej dy fotove që Ioanna Gaka kishte bërë me Mazonakis dhe më pas ia kishte dërguar një marrësi ende të paidentifikuar. Sipas të dhënave të ekspertizës dixhitale, Gaka kishte bërë dy fotografi dhe një video më 9 shtator. Të tre skedarët rezultojnë të jenë fshirë përpara se ajo të paraqitej në Stacionin e Policisë Kypseli për të dhënë deklaratën e saj.

Fotografia e parë është realizuar në orën 14:43:36 dhe skedari është krijuar 43 sekonda më vonë. Ai është fshirë në orën 19:09:09. Në imazh, Mazonakis shihet i shtrirë në shtratin e klinikës, ndërsa makina është në punë. Ai mban një bluzë të verdhë dhe është i mbuluar me batanije nga mesi e poshtë. Në duart e tij dallohen pajisje mjekësore, ndërsa një element i rëndësishëm për hetuesit janë të dhënat e vendndodhjes të ruajtura në metadatat e fotografisë. Koordinatat përputhen me një pikë në rrugën Karneadou në Athinë, në zonën ku ndodhet klinika.

Pikërisht në lidhje me këtë fotografi janë evidentuar edhe gjurmë dixhitale të shpërndarjes. Sipas hetimit, fotografia i është dërguar një marrësi të panjohur, identiteti i të cilit ende nuk është përcaktuar. Deri tani nuk ka të dhëna që fotografia t'i jetë dërguar Elias Theodoropoulos. Fotografia e dytë është realizuar në orën 14:45:22 dhe skedari është krijuar katër sekonda më vonë. Edhe kjo fotografi rezulton e fshirë, ndërsa koha e fshirjes është 19:09:13, vetëm pak sekonda pas fshirjes së imazhit të parë. Edhe fotografia e dytë përmban të njëjtat koordinata gjeografike.

Në telefonin e Gakës është gjetur gjithashtu një video e fshirë, e realizuar në orën 14:43:55, pra mes dy fotografive. Sipas të dhënave të ekspertizës, edhe kjo video është fshirë në orën 19:09:13. Për hetuesit, rikuperimi i të dhënave të fshira konsiderohet tashmë një element kyç. Ata synojnë të përcaktojnë se kujt i është dërguar fotografia, përmes cilit aplikacion është shpërndarë, nëse ka pasur mesazhe shoqëruese dhe nëse materiali është përcjellë më tej.

Identifikimi i marrësit mund t'i japë një drejtim të ri hetimit, veçanërisht nëse komunikimi përputhet me kronologjinë e ngjarjeve brenda klinikës. Në fokus të autoriteteve janë edhe telefonat celularë të tre punonjësve të klinikës. Hetuesit pritet të analizojnë komunikimet, mesazhet, telefonatat, fotografitë, videot dhe çdo gjurmë tjetër dixhitale që mund të ndihmojë në rindërtimin e ngjarjeve. Një tjetër pistë që po shqyrtohet është mundësia që Mazonakis t'i jetë administruar një substancë para ose gjatë plazmaferezës. Deri tani nuk është identifikuar një substancë specifike dhe autoritetet presin rezultatet e analizave toksikologjike.

Hetimi po përpiqet të përcaktojë nëse ndonjë substancë është administruar në rrethana që kërkojnë praninë dhe mbikëqyrjen e personelit të specializuar mjekësor. Rezultatet e ekspertizave dixhitale dhe toksikologjike pritet të jenë vendimtare për të hedhur dritë mbi rrethanat e vdekjes së Mazonakis.

Artikuj te sugjeruar

SHOWBIZ 15 Shtator22:35

[Bebe Rexha flet për vizitat e shpeshta që bënte në Maqedoni gjatë fëmijërisë: Dasmat shqiptare zgjasnin deri në 3 të mëngjesit](#)

Këngëtarja shqiptare me famë ndërkombëtare, Bebe Rexha, ka folur së fundmi për kujtimet e saj të fëmijërisë&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator22:13

[“Ky vit do të jetë ndryshe”, Xhensila Myrtezaj me premtim të madh për fansat](#)

Këngëtarja e njohur, Xhensila Myrtezaj, ka ndarë me ndjekësit disa momente nga koncertet e saj, duke shoqëruar fotografitë dhe vid...

SHOWBIZ 15 Shtator22:01

[Ka gjetur dashurinë pas divorcit? Këngëtarja Maya “hap zemrën”](#)

Këngëtarja e njohur Maya Aliçkaj ka folur për jetën e saj private gjatë një interviste duke treguar se aktualisht jeton vet...

SHOWBIZ 15 Shtator20:56

[Selin Bollati zbulon se çfarë ndodhi me 100 mijë eurot e fituara nga BBVA](#)

Fituesja e edicionit të pestë të reality show-t “Big Brother VIP Albania”, Selin Bollati, ka ndarë prapaskenat e përvoj&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator20:01

[“Të don djali shumë”, Gimbo uron nënën për ditëlindje me foton e rrallë, artisti i vogël me çifte në duar](#)

Nëna e DJ të famshëm Gëzim Blakaj, të njohur si Gimbo feston ditën e sotme ditëlindjen, e i biri ka zgjedhur një m&eum...

SHOWBIZ 15 Shtator19:35

[“Eksperimentova, shkoj shumë mirë”/Egli Tako flet për projektet e saj muzikore: Do kthehem tek baladat](#)

Egli Tako ka qenë e ftuar në studion e “Live From Tirana” në Top Albania Radio, ku ka folur më shumë për projektet e s...

SHOWBIZ 15 Shtator18:36

[“Më vjen turp që i dola kundër”, G Bani pendohet për Jozin: Më fal, sulm i ulët kundër teje](#)

G Bani ka rikthyer së fundmi në qendër të vëmendjes një nga momentet më të bujshme të “Big Brother VIP Alba...

SHOWBIZ 15 Shtator17:54

[Ledri Vula i dedikon tatuazh të veçantë Poem Blu, vajza i “përgjigjet” me gjestin e ëmbël](#)

Një ditë e rëndësishme për Poem Blu u kthye në një kujtim të paharrueshëm edhe për babain e saj, Ledri Vul&e...

SHOWBIZ 15 Shtator15:49

[Tom Holland bën histori në Hollywood, bëhet aktori me filmat më fitimprurës i të gjitha kohërave](#)

Tom Holland ka shënuar një tjetër sukses të madh në karrierën e tij, duke u ngjitur në krye të listës s...

SHOWBIZ 15 Shtator15:06

[“Ajo ishte nëna ime”, Macaulay Culkin shpërthen në lot në Emmy Awards, fjalët për Catherine O’Hara prekin gjithë sallën](#)

Një skenë që i përloti të gjithë. Macaulay Culkin nuk mundi t’i mbante emocionet teksa u ngjit në skenën e Emmy Aw...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

[Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...](#)

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

AKTUALITET 15 Shtator

[Rrëfihet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashk&e...

AKTUALITET 15 Shtator

[Gjykata e Lartë merr vendimin për kreun e Bashk...](#)

Gjykata e Lartë shqyrtoi sot rigjykimin e çështjes që lidhet me masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Eri...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.